



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060-2807 dt. 19. 01. 2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **23.12.2021**
Me gjerësisht, mbledhja e tretë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes inauguruese i Kuvendit Komunal i mbajtur me: 03.12.2021 dhe procesverbali i mbledhjes se zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit Komunal i dt. 16.12.2021.
2. Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF-ca)
3. Themelimi i Komitetit për Komunitete. (KK)
4. Themelimi i Këshillit për siguri në Bashkësi (KKSB)
5. Informim i Kuvendit Komunal për gjashtëmujorin e dytë të KKSB-së.
6. Të ndryshme.



Prezent gjatë mbledhjes ishin: Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, nënkryetari i komunës z.Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, dhe anëtarët e Kuvendit komunal.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hadari- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës, theksoj se për diskutim janë 8 pika, kemi edhe dy propozim vendime shtesë: 1. Propozim vendim për lirimin nga qiraja joprofitabile për familjet përfutuese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2022, dhe
2. Propozim vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022.

Azemine Gjoka - ne si grup parlamentar te DD, kërkojmë që kjo pikë të shtyhet për arsyeje se nuk është shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, pika e 7. Propozim vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022.

Drejtori i Financave, Shyqeri Bublaku- obligimi ligjor sipas ligjit për Propozim vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022, që kuvendet komunale deri me 30 nëntor të aprovojnë normat tatimore për vitin në vijim, ndërsa ne për arsye të zgjedhjeve lokale që kanë qenë nuk kemi pas mundësi para 30.09.2021 sepse nuk ka qenë kuvendi aktiv u dashtë me shku me këtë mas. Për arsye kërkoj që te diskutohet dhe kërkoj ta votoni këtë propozim vendim.

Arbër Halilaj- me sa kam informacion normat tatimore bazohen në raportin e vlerësimi të përgjithshëm për pronat bujqësore dhe pyjore që e ka bërë Ministria e Financave me dt 29.10.2022.

Drejtori i Financave, Shyqeri Bublaku- ne baze te neni 9 të ligjit për tatimin në pronë e paluajtshme caktohet data, Kuvendet Komunale në çdo komunë caktojnë normat tatimore për të gjitha kategoritë e pronave me përjashtimin të kategorisë të pronave publike deri më 30 nëntor para vitit të vendosjes se tatimit në përputhje me këtë ligj.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Milaim Hajdari, hodhi në votim rendin e ditës me këto dy pika shitesë, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar:

Për votuan 12 anëtar, kundër 10, abstenim 04.

Rendi i Ditës i miratuar.

1. Procesverbali i mbledhjes inauguruese i Kuvendit Komunal i mbajtur me: 03.12.2021 dhe procesverbali i mbledhjes se zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit Komunal i dt. 16.12.2021.
2. Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF-ca)
3. Themelimi i Komitetit për Komunitete. (KK)
4. Themelimi i Këshillit për siguri në Bashkësi (KKSBB)
5. Informim i Kuvendit Komunal për gjashtëmujorin e dytë të KKSBB-së.
6. Propozim vendim për lirim nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2022
7. Propozim vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: Procesverbali i mbledhjes inauguruese i Kuvendit Komunal i mbajtur me: 03.12.2021 dhe procesverbali i mbledhjes se zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit Komunal i dt. 16.12.2021.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar:

Për votuan 29 anëtar, kundër 00, abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF-ca)**

Beqir Kiqina- sa i përket kësaj pike Kuvendi Komunal i Drenasit duhet me pas të qartë se duhet me u përfshi të gjitha etnitete politike në bazë të përqindjes dhe në bazë të përfaqesimit në kuvend, kryesuesi shkon me automatizem, partia më e madhe shkon me 2 anetar ndersa partite tjera nga një anëtar, kërkoj që të propozohet nga të gjitha partitë ashtu siç i takojnë me radhë duke pas parasysh edhe kuoten gjinore.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, kërkoj nga anëtarët e kuvendit komunal që t'i propozojnë anëtarët e tyre nga subjektet politike.

Bekim Lestrati- Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, propozon Malsore Cakiqi dhe Hamit Kastratin.

Marigona Bazaj- Nga Grupi Parlamentar i DD-së, propozon për anëtar të Komitetit për Politike dhe Financa Azemine Bujupi-Gjoka dhe Hamit Haxhiu.

Egzona Tërdevci- pajtohem me diskutimin e z. Kiqina, mendoj se Komiteti për Politikë dhe Financa duhet me i përfshi të gjitha etnitete Politike brenda komunës, sa i përket Komitetit për Politike dhe Financa ne propozojmë: Florentina Elezi-Veliu.

Valentina Leku- Nga Grupi Parlamentar GREEN, për anëtar të Komitetit për Politike dhe Financa propozojmë Arber Halilaj.

Zeqir Hasi- sa i përket kësaj pike unë nuk pajtohem me grupin kuvendar të PDK-së kërkoj një sqarim pse nuk më është lejuar që të kandidoja edhe si anëtar në Komitetin për Politikë dhe Financa nëse jo, unë do të bëjë ankese pse me është mohuar e drejta për kandidim pranë ministrisë përkatëse.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar:

Për votuan 27 anëtar, kundër 02, abstenim 00.

Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) është miratuar me këtë përbërje;

1. Milaim Hajdari – kryesues
2. Malsore Cakiqi – anëtare (PDK)
3. Hamit Kastrati – anëtar (PDK)
4. Azemine Gjoka – anëtare (DD)
5. Hamit Haxhiu – anëtar (DD)
6. Florentina Elezi-Veliu – anëtare (LVV)
7. Arbër Halilaj – anëtar (GPD)

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: 3. Themelimi i Komitetit për Komunitete. (KK), në bazë të udhëzimit administrativ ky komitet përbehet prej 5 anëtar, 3 përfaqësues janë nga asambleja komunale ndërsa dy përfaqësues nga shoqëria civile prej komitetit të biznesit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- nga shoqëria civile propozoj Eronita Brahimi – anëtare (OJQ), Sokol Gashani - anëtar (përfaqësues i bizneseve)

Bekim Lestrani- nga grupi parlamentar i PDK-së propozojmë për anëtar të Komitetit për Komunitete Agnesë Kastrati.

Azemine Bujupi-Gjoka - nga grupi parlamentar DD propozojmë për anëtar të Komitetit për Komunitete Margiona Bazaj.

Egzona Tërdevci - nga grupi parlamentar LVV për anëtar të Komitetit për Komunitet propozojmë Drin Halilaj.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar:

Për votuan 27 anëtar, kundër 00, abstenim 01.

Themelimi i Komitetit për Komunitete është miratuar me këtë përbërje;

1. Agnesë Kastrati-Bucolli – anëtare (PDK)
2. Marigona Bazaj – anëtare (DD)
3. Drin Halilaj – anëtar (LVV)
4. Eronita Brahimi – anëtare (OJQ)
5. Sokol Gashani – anëtar (përfaqësues i bizneseve)

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës. 4. Themelimi i Këshillit për siguri në Bashkësi (KKSB)

Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) është miratuar me këtë përbërje;

1. Ramiz Lladrovci – kryetar
2. Laureta Thaqi – Koordinatore
3. Gentianë Morina – Zyrtare për barazi gjinore
4. Feime Bajrami – Komandante e Stacionit Policor në Drenas
5. Valon Bequku – Bashkësia Islame
6. Meriton Sopi – Komuniteti Katolik
7. Muhamet Gjoka – Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit
8. Arben Haziri – Këshilli i Prindërve
9. Edolind Vishaj – Forca e Sigurisë së Kosovës
10. Arben Nika – Ekipi i Veprimit për Siguri në Bashkësi (EVSB)
11. Lumnije Krapa - Drejtoreshë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë
12. Afije Veseli – Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
13. Kadire Tahiraj – OJQ
14. Erlind Krasniqi – përfaqësues i mediave
15. Behxhet Binaku – përfaqësues i Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK)
16. Haxhi Lladrovci – përfaqësues nga bizneset
17. Donika Zogu – Këshilli i Veprimit Rinor Lokal
18. Një përfaqësues nga KLSP, do të zgjidhet
19. Kryesuesi/ja nga Komiteti për Komunitete (pasi të zgjidhet në mbledhjen e parë nga Komiteti për Komunitete)

Pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar:

Për votuan 18 anëtar, kundër 00, abstenim 08, miratohet Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) me këtë përbërje të anëtareve të cekur me lartë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës 5. Informim i Kuvendit Komunal për gjashtëmujorin e dytë të KKSB-së

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- e kemi obligim ligjor për me raportua dy herë në vit për KKSB-në, nuk votohet kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim vendimi për lirim nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2022**

Egzona Tërdevci - grupi parlamentar LVV në parim përkrah propozim vendimi për lirim nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2022, por për ne paraqet shqetësim fakti se dokumenteve të përmendura në propozim vendimin që na keni dergu përkatësisht vendimin e dt. 29.11.2019 i cili është vlerësuar nga MAPL-ja dhe është publikuar në faqen e komunës 24.12.2019 me supozimin se kontratat janë të nënshkruara në të njëjtën kohë i bie se këto kontrata tashmë nuk janë valide ose ne ditët e afërta nuk do të kenë validitet, ne si grup parlamentar duke pas parasysh ndjeshmërinë e çështjes në fjalë bëjmë thirrje që në afat sa më të shkurtër të formohet komisioni që të behet vlerësimi i ligjshmërisë së këtyre kontratave.

Drejtori i Shëndetësisë, Arsim Haxhiu- rreth kësaj çështje aty i keni datat nuk e ke krejt dosjen, kontrata janë të nënshkruar në bazë të vendimit dhe janë valide, kontratat janë nënshkruar më vonë, dhe në kontrata janë të përcaktuara në bazë të ligjit për caktimin e zbatimit social 03/L-164 dhe e programit tre vjeçar të banimi social të aprovuar në kuvend, dhe në momentin plotësimit dy vjetar sepse dy vjet është kontrata e shfrytëzimit të behet shpallja publike, meqenëse për vitin 2020-2022 për shkak të gjendjes aktuale me covid ky kuvend i ka liru nga qiraja këta, pasi që situata është ende e njëjte besoj se do t'i lirojmë edhe për këtë vit, ndërsa procedurat tjera sigurisht që do t'i shikojmë.

Egzona Tërdevci, kërkoj për hir të transparencën me na e treguar datën kur janë nënshkruar këto kontrata, vetëm me e shiku a janë ende valide apo jo.

Drejtori i shëndetësisë, Arsim Haxhiu- ju i keni disa vendime, janë vendimet e ndryshimeve, duke pas parasysh që komisioni bene kontrollin e banimit social në periudha të caktuara kohore gjate vitit, tre mujor dhe çdo çrregullim në aspektin e shfrytëzimit të banimit siç e parasheh programi i banimit tre vjeçar komunal , dhe ligji për banim të përkohshëm social ose kanë bërë zgjidhje të banimit janë nënshkruar disa vendime të cilat janë plotësuar, janë liru dy banesa ata që kane aplikuar kuvendit përsëri ka marr vendim, ato kontrata janë nënshkruar më vonë, çdo vendim që është nxjerr me plotësim ndryshim dhe janë të nënshkruara më vonë, ne momentin që skadohen ato kontrata ato kontrata shpallen ne periudha kohore.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nuk kanë të bëjnë kontrata me këtë çështje, ne e kemi bërë një propozim vendim, kontratat lidhen pas një verifikimi të një komisioni ku pjese e komisionit është edhe asambleja, ne po kërkojmë kushdo që edhe banues ne banesat e banimit social me vendos me i liru prej pagese, doni me i liru apo jo, nuk ka të bëjë me kontrata, kontrata lidhen pasi komisionet e caktuara, ose atyre që ju ka skaduar në komision pranohen banuesit e ri ku e përcakton një komision që përbehet nga 7 anëtar 4 janë nga kuvendi.

Arber Halilaj, edhe ne si GREEN për Drenasin jemi që këtyre kategorive sociale që t'ju ndihmojmë sidomos duke pas parasysh implikimet e pandemisë dhe gjendjes sociale të renduar, vetëm për shkak të korrekhtësisë dhe saktësisë ne seanca tjera kur kemi vendime të tilla me e bashkëngjiti një liste me e shiku kush po përfiton.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal votuan në mënyre unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës 7. **Propozim vendimi për caktimin e normave tatimore për Tatim në Pronën e Paluajtshme për vitin 2022.**

Hamit Haxhiu, në bazë të ligjit 06/L-05 për tatimin në pronë kërkoj një sqarim pse ne normat e interesit ka ndryshime, në bazë të nenit c, për njësit industriale të parcelave dhe për njësit industriale të objekteve pse ka ndryshim të përqindjes ?

Drejtori i Financave-Shyqiri Bublaku, shkallët tatimore janë edhe me ligj sipas nenit 9 të ligjit për pronën e paluajtshme dhe kemi shkuar ne normat më të ulta duke u bazuar në situatën pandemike , duke pas parasysh gjendjen ekonomike në komunën tonë të gjitha normat janë ose ne shkallen e parë më të ulët ose janë një shkallë me të lartë në bazë të ligjit këto janë propozimet tona dhe ju jeni nga ata që i bëni ndryshimet.

Arber Halilaj, i kam krahasu normat tatimore psh Prishtina propozoj për njësit industriale të parcelave dhe njësit industriale të objekteve e ka 0.17% më e ulët se Drenasi, propozoj që që të gjitha njësit komerciale të parcelave dhe për njësit industriale të objekteve të jenë 0.16, ndërsa vetëm normat tatimore 0,15 %.

Drejtori i Financave-Shyqiri Bublaku, sa i përket njësit industriale ne kemi shkuar me 0.20% për shkak se ne e kemi industrinë e feronikelit të cilën që përveç dëmeve që na shkakton në ambient është marrë edhe kjo për bazë dmth është ngrit në 0.20 % për këtë arsye ka qenë ky propozim vendim.

Bekim Lestrani, unë kisha kërkuar me vazhdu me 0.20 % për arsye se komuna jonë ka nevojë për të hyra vetanake, ndërsa Komuna e Prishtinës kanë mjaft të hyra vetanake, jemi komunë që nuk mundemi me mu krahasu me komunën e Prishtinës.

Arber Halilaj, pas sqarimeve e tërhoqi atë që e ceki më lartë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar:

Për votuan 28 anëtar, kundër 00, abstenim 00

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës 8. **Të ndryshme.**

Drin Halilaj, bazuar në udhëzimin administrativ nr. 03/2020 për transparencë në komuna përkatësisht neni 4 paragrafi 1 dhe 8 si dhe duke pas parasysh dhe duke pas parasysh që mbledhjet e Kuvendit Komunal transmetohen në you tube dhe në ueb faqen e komunës, në emër të grupit parlamentar në LLV propozojmë transmetimin e mbledhjes së Kuvendit Komunal dhe atyre të Komitetit në faqen zyrtare në Facebook, ne mendojmë se kjo do të rrit transparencën karshi qytetareve do ndikonte në përfshirjen e qytetareve tanë në vendimmarrje dhe në të njëjtën kohë përcjellja e një audience më e madhe do të na bënte edhe neve më të përgjegjshmen në raport me obligimet tona, kjo kërkesë e jona realizohet me 0 kosto financiarë dhe di e tillë e shohim të lehtë të realizueshme, me qellim se sa ma afër të qytetareve tanë kërkojmë mbështetjen e tuaj për këtë propozim.

Florentina Elezi, pati një shqetësim për banoret që banojnë në rrugën "Ahmeti" në Drenas, është një ndërtesë e ndërtuar nga një ish drejtor i komunës e cila nuk ka pëlqim energjetik për lidhje në trafo dhe po e bënë këtë ilegalisht dhe në momentin ka pëlqim energjetik, nuk i

plotëson kushtet për banim por aty ka banor që banojnë dhe po ju shkakton shumë telashe edhe banoreve bizneseve sidomos të cilët janë të lidhur në trafon e rrymës, kërkoj me marr urgjent masa për shkak se po ju shkakton shumë dëme bizneseve të vogla të cilat janë në atë pjesë, ky është problem që ju shkakton çdo ditë dhe duhet ndërhyrje e menjëhershme e komunës për me i evitua edhe pasojat ma të mëdha.

Nënkryetari i komunës Arben Shala, sa i përket çështjes në fjalë jemi në dijeni dhe e kemi adresuar me kohë tash mbetet KEDS- i të vendos.

Hamit Haxhiu, të statuti i Komunës ku fol për Komitetin për Politikë dhe Financa e keni me numër të anëtareve 9 ndërsa në baze të ligjit për vetëqeverisje lokale është 7, kërkoj që ajo pikë të rregullohet.

Egzona Tërdevci, ne e kemi të qartë se jemi transparent në faqen e komunës dhe në kanalin you tube, por nëse hyn dhe i sheh seancat ka shumë pak shikime, ne po synojmë një audiencë me të madhe ne kemi më shumë votues se sa aq dhe njerëzit po donë më e shiku punën tonë, duke pas parasysh se faqja e komunës në facebook ka më shumë se 13 mijë like ne synojmë të mbërrijmë tek ajo audiencë, konsiderojmë se propozimi jonë është në rregull me ligjin dhe nuk ka komplikime teknike.


Arber Halilaj, ka komuna tjera më të vogla që i transmetojnë seancat live në facebook, mendoj se do ta votojmë këtë propozim edhe ne.

Azmine Gjoka, edhe ne si grup parlamentar DD e përkrahim këtë propozim.

Kryesuesi i kuvendit Komunal Milaim Hajdari, ne e diskutuam me zyrën e informimit këtë çështje na premtuan se do të kryhet ky shërbim. Është diçka teknike që rregullohet.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 11.45 min.


Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari